

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 24 MARS 2022

E nderuar drejtuese e seancës,

I jam drejtuar me pyetjen, që ju sapo referuat, ministrit të Brendshëm, pasi kam kërkuar edhe nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës fillimin e hetimeve për veprimet e personave të pidentifikuar në protestat e fundit, por edhe në protestat e tjera të mëparshme. Është bërë normë dhe mënyrë të vepruari ndërhyrja e dhunshme e këtyre personave me kapuçë të zinj, pa asnjë mjet identifikimi që dhunojnë e marrin zvarrë protestuesit.

Në rastin e fundit, kur protestat ishin tërësisht paqësore, këta njerëz, të cilët ngjajnë vërtet si gangsterë, por që nuk kanë lidhje me policinë, ndërhyjnë dhe i izolojnë personat, i arrestojnë, i marrin zvarrë dhe i dhunojnë. Njëherazi, kemi të tillë civilë prapë me kobure në brez. Ja ku e ka koburen! Njerëz të vetmuar, të izoluar vërsulen si shtazë mbi ta dhe e gjithë kjo situatë zhvillohet në sytë e publikut dhe i vetmi preokupacion, i regjistruar me zë dhe me figurë, është që drejtuesit e policisë i njoftojnë dhe u tërheqin vëmendjen që të kenë parasysh se ka kamera dhe mjete identifikimi.

Pra, është një veprim krejtësisht ilegal, një veprim horrash, të cilët duan të bëjnë çdolloj paligjshmërie dhe preokupacioni i vetëm i tyre është që të mos identifikohen. Nuk e di se cili nga ju në sallë do të pranonte të rrëmbehej dhe të dhunohej nga horra të këtij niveli.